



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 28.04.2023

Nr: 67

Ora: 10:00

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 52, DATË 26.04.2023 TË DEPOZITUAR NGA PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, DEGA KLOS

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 28.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Socialiste, Dega Klos, përfaqësuar nga z. Armand Gjini.

OBJEKT: Shfuqizimi i vendimeve nr. 32, 33, 58, 42, 46, 47, 48, 51, 52, 54 dhe 55 datë 24.04.2023 të KZAZ-së nr. 17 “Për emërimin e anëtareve të Komisionit të qendrës së votimit nr. 0939, nr. 0941, nr. 0943, nr. 0993, nr. 0997, nr. 0998, nr. 0998/1, nr. 1002, nr. 1003, nr. 1025, nr. 1026 ‘Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023’”.



BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “c”, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Socialiste e Shqipërisë, dega Klos ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 52 regj., datë 26.04.2023.

Në mbledhjen e datës 28.04.2023, ora 10:00, pas relatimit të anëtarit z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 52 nuk i plotësonte në mënyrë kumulative elementet e parashikuara në nenin 130, të K.Zgjedhor, më konkretisht atë të parashikuar nga neni 130 pika 1 shkronja “b” e tij, pasi ankuesi z. Armand Gjini nuk arriti të provonte se kishte tagra për të depozituar kërkesa ankimore pranë KAS, tagër ky që jepet nga subjekti zgjedhor të cilin ankuesi përfaqëson. Gjatë seancës, palës ju dha mundësia për të depozituar aktet e përfaqësimit, pavarësisht kësaj, aktet që paraqiti, përveçse nuk ishin në formën e kërkuar nga ligji, nuk e autorizonin për të depozituar ankim në KAS. Për rrjedhojë, në mungesë të një autorizimi të dhënë nga Partia Socialiste e Shqipërisë, subjekti ankues nuk legjitimohet në paraqitjen e këtij ankimi.

Në mbështetje të nenit 17 pika 3 shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe nenit 129 pika 3 shkronja “b” të K.Zgjedhor kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 52, datë 26.04.2023, të paraqitur nga Partia Socialiste Dega Klos, përfaqësuar nga z. Armand Gjini, për shkak moslegjitimimi të subjektit ankues;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - Relator

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar